

20141996125

L I G J PËR VEPRIMTARI BOTUESE

Objekti i rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kryerja e veprimtarisë botuese, të dhënat e detyrueshme të publikimit, numrat standardë ndërkombëtarë, shkresa-CIP e katalogut, parashtrimi i ekzemplarit obligues, si dhe çështje tjera në lidhje me kryerjen e veprimtarisë botuese.

Domethënia e shprehjeve të veçanta në këtë ligj (lista e nocioneve)

Neni 2

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë domethënien në vijim:

1. **Veprimtari botuese** është botimi, distribuimi dhe qarkullimi i publikimeve në formë të shtypur dhe elektronike në më shumë ekzemplarë që janë të dedikuar për publikun;

2. **Me publikim** nënkuptohen: libra, broshura, publikime në seri dhe burime të vazhdueshme (revista, gazeta e të tjera), punime muzikore (partitura dhe akorde), material hartografik (harta, plane, globusë e të tjera), atlase, riprodhime të pikturave artistike dhe vizatimeve, pllakatë, kartolina, katalogë, kalendarë, programe artistike dhe skenike, bartës të tingullit, bartës të tingullit dhe fotografisë, (përveç veprave audiovizuele) dhe të tjera, pavarësisht se në cilin lloj të medias janë të arritshme në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve, që shumohen me shtypje, pasqyrim, kopjim ose në mënyrë tjetër dhe janë të dedikuara për publikun.

Me publikim, në kontekst të këtij ligjit, nuk konsiderohet material i shtypur ose i shumuar në mënyrë tjetër që shërben vetëm për nevoja zyrtare të: organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, partive politike, organizatave joqeveritare, institucioneve dhe personave tjerë juridikë, si dhe publikimi që është i përfshirë në pikën 2 të këtij neni, por nuk është i dedikuar për publikun;

3. **Publikim elektronik** është publikimi i shpallur në formë elektronike si tërësi e veçantë fizike e arritshme në internet, e publikuar në domenin e Republikës së Maqedonisë ose publikimi që është përgatitur për shtyp në formë që përputhet me standardet ndërkombëtare dhe informatat përgjithësisht të arritshme, programe kompjuterike për përdorim publik dhe të tjera;

4. **Botues** është personi juridik i regjistruar për kryerje të veprimtarisë botuese;

5. **Shtëpi botimi** është personi juridik i regjistruar të kryejë veprimtari botuese të publikimeve për nevojat e botuesit;

6. **Ekzemplar obligues** është numër i ekzemplarëve të secilit botim të publikimit, të cilin botuesi është i obliguar t'i dorëzojë në institucionin Biblioteka Nacionale dhe Universitare “Shën Kliment Ohridski” – Shkup;

7. **Botim** janë të gjithë ekzemplarët e një publikimi nga e njëjta vepër origjinale që e ka botuar botuesi pa marrë parasysh median në të cilën është botuar;

8. **Botim i përsëritur ose i plotësuar** është botim i publikimit paraprakisht të botuar, në formë të ndryshuar (me ballinë të ndryshuar, kopertina të ndryshuara ose të reja, tekst të plotësuar ose ndryshuar, fotografi të reja, karta dhe ngjashëm) në format të njëjtë ose të ngjashëm;

9. **ISBN (ISBN)** është numër standard ndërkombëtar për libra (internacional standard book number) me të cilin identifikohet botimi pa marrë parasysh në cilën media është i arritshëm;

10. **ISSN (ISSN)** është numër standard ndërkombëtar për publikime periodike dhe burime të vazhdueshme (internacional standard seria number) me të cilin identifikohet titulli i publikimit periodik ose burimit të vazhdueshëm pa marrë parasysh në cilin lloj të medias është i arritshëm;

11. **ISMN (ISMN)** është numër standard ndërkombëtar për botime muzikore të notave (internacional standard music number) me të cilin identifikohet publikimi i shpallur muzikor (partitura, akorde dhe sete multimediale);

12. **ISRC (ISRC)** është numër standard ndërkombëtar për audioincizime (shkresa) dhe videoincizime muzikore (internacional standard recording code) me të cilin identifikohen audioincizimet dhe videoincizimet muzikore;

13. **ISAN (ISAN)** është numër standard ndërkombëtar për vepra audiovizuele dhe për versione të tyre në të cilat janë përfshirë filma me metrazh të gjatë dhe të shkurtër, filma dokumentarë dhe të animuar, programe televizive, ngjarje sportive, reklama dhe të tjera;

14. **ISVC (ISWC)** është numër standard ndërkombëtar i veprës muzikore me të cilën identifikohen veprat muzikore;

15. **DOI (DOI)** është identifikues ndërkombëtar i objekteve digjitale – dokumenteve elektronike, që mund të realizohet nëpërmjet sistemeve Hendëll dhe Krosref (Handle dhe Crossref);

16. **HANDLE.NET** është sistem për lidhje të përhershme (linqe) në objektet digjitale;

17. **CIP – shkresë (CIP– shkresë) (Cataloguing in publication – katalogizim në publikim)** është përshkrim njohës i standardizuar në katalog në nivel ndërkombëtar për një publikim (të shtypur apo elektronik) të përpiluar para shtypjes ose prodhimit të tij, e i inkorporuar në vet publikimin. Me CIP– shkresë përfshihen këto lloje të publikimeve: libra, punime muzikore (partitura dhe akorde), atlase, bartës të tingullit, bartës të tingulli dhe fotografisë dhe të tjera, pavarësisht në cilën media janë të srritshëm. Në CIP– shkresë nuk bëjnë pjesë publikime periodike, roto-romane, fotoalbume pa tekst dhe autor, tekste interne dhe tekste në përgatitje (teza, para-drafte, drafte, propozime), efemeride (lista të adresave, lista të emrave, raporte), material hartografik (harta, plane, globe dhe të tjera), publikime reklamash, prospekte, programe artistike dhe skenike, lista të çmimeve, tarifa, udhëzime për përdorim dhe mirëmbajtje, pllakata, fletushka (materiale propaganduese partiake parazgjedhore), ftesa, fotografi, patenta, standarde, kalendarë muri dhe të ngjashëm, projekte shkencore hulumtuese, punime magjistrature dhe doktorature.

Neni 3

(1) Veprimtari botuese kryejnë persona juridikë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë për kryerjen e veprimtarisë botuese.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, veprimtari botuese mund të kryejë edhe autori i veprës së vet (botim autori).

(3) Dy ose më shumë botues mund të jetë bashkëbotues të publikimit të njëjtë.

Neni 4

(1) Botuesi doemos duhet të ketë redaktor, i cili është përgjegjës për prodhimin e tij të përgjithshëm botues.

(2) Redaktori kryen zgjedhjen e publikimeve për shpallje, merr dhe jep mendim profesional për publikimin dhe është përgjegjës për cilësinë e publikimit të botuar.

(3) Botuesi, krahas redaktorit, përkatësisht redaktorit të publikimit, mund të ketë këshill redaktues, këshill të redaksisë, organizator, recensent, lektor, korrektor, përkthyes, redaktor artistik dhe teknik të publikimit.

Marrëveshja për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve të ndërsjella

Neni 5

(1) Para botimit të publikimit, botuesi me autorin e veprës dhe me personat tjerë që marrin pjesë në përpunimin e publikimit (autor, posedues i të drejtës autoriale, redaktor, organizator, përkthyes, redaktor, recensent, lektor, korrektor, redaktor artistik dhe teknik dhe të tjerë) nënshkruan marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella në lidhje me botimin e publikimit.

(2) Për marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen dispozitat e të drejtës autoriale dhe të drejta të ngjashme edhe për marrëdhëniet obliguese.

Obligime të botuesit

Neni 6

(1) Botuesi është i obliguar:

- t'i mundësojë autorit futjen e korigjimeve përmbajtësore dhe teknike të publikimit në fazën e përpunimit teknik;

- t'i mundësojë autorit ndryshime përkatëse gjatë përgatitjes së çdo botimit të ardhshëm, si dhe blerje të ekzemplarëve të pashitur të publikimit;

- ta njoftojë autorin për qarkullimin e publikimit të lëshuar.

(2) Botuesi është i obliguar ta botojë publikimin në tirazhin që është shënuar si e dhënë e detyrueshme e publikimit.

(3) Botuesi në janar në vitin rrjedhës për vitin paraprak në Institucionin Nacional Biblioteka Nacionale Universitare dhe “Shën Kliment Ohridski” - Shkup parashtrohet raport vjetor për produksionin e vet botues.

(4) Formën dhe përmbajtjen e raporti vjetor nga paragrafi (3) i këtij neni i përcakton ministri i Kulturës.

Të dhëna obliguese të publikimit

Neni 7

(1) Çdo publikim përmban të dhëna në vijim:

- të dhëna për botuesin/bashkëbotuesin (emri dhe selia)/emri dhe mbiemri i autorit për botimin autorial;

- titullin e publikimit dhe emrin dhe mbiemrin/emra dhe mbiemra të autorit/autorëve, bartësit të së drejtës autoriale;

- emrin dhe mbiemrin e redaktorit, përkthyesit, organizatorit, ilustruesit, lektorit dhe personave tjerë;

- emrin dhe selinë e vendit të shtypshkronjës/prodhuesit;

- vendin e botimit;

- vitin e botimit, numrin e publikimit periodik;

- gjatë botimit të sërishëm, të dhëna për botuesin, vendin dhe vitin e botimit të edicionit të parë nëse të dhëna të tilla janë të kapshme;

- shenjën C (copyright) me emrin e bartësit të së drejtës autoriale dhe vitin e botimit të parë;

- tirazhin e publikimit;

- CIP-shkresë ose numrin identifikues të CIP-shkresës (për ato publikime që i nënshtrohen CIP-shkresës);

- numra standardë ndërkombëtarë për publikimin (ISBN, ISSN, ISMN, ISRC, ISAN, ISWC, DOI, HANDLE.NET).

(2) Te publikimet e përkthyer, krahas të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, kur publikimi është përkthim i veprës burimore (origjinale), doemos duhet t'i përmbajë titullin dhe gjuhën në të cilën është shkruar publikimi burimor, e në rast kur publikimi i përkthyer është përkthim nga përkthimi i veprës origjinale, doemos duhet t'i përmbajë edhe titullin dhe gjuhën e përkthimit të ndërmjetëm që është shfrytëzuar gjatë përkthimit të veprës origjinale.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në publikimet, si: riprodhime të pikturave artistike dhe vizatimeve, pllakatës, kartolinë, kalendar dhe programe artistike dhe skenike, shtypen vetëm titulli dhe selia e botuesit dhe viti i botimit.

Numra standardë ndërkombëtarë

Neni 8

(1) Numrin standard ndërkombëtar për libra (ISBN), numrin standard ndërkombëtar për publikime periodike dhe burime të vazhdueshme (ISSN), numrin standard ndërkombëtar për botime muzikore të notave (ISMN) i lëshon Institucioni Nacional Biblioteka Nacionale dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski" - Shkup (në tekstin e mëtejme: Biblioteka Nacionale).

(2) Për lëshimin e numrave standardë ndërkombëtarë (ISRC, ISAN, ISWC, DOI, HANDLE.NET), Biblioteka Nacionale i udhëzon botuesit te qendrat ndërkombëtare që janë kompetente për lëshimin e tyre.

(3) Numrat standardë ndërkombëtarë nga paragrafi (1) i këtij neni të shpallura në publikim doemos duhet të jenë identikë me numrat që i ka lëshuar Biblioteka Nacionale.

(4) Numrat standardë ndërkombëtarë nga paragrafi (1) i këtij i lëshon Biblioteka Nacionale në afat prej shtatë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(5) Për lëshimin e numrave standardë ndërkombëtarë nga paragrafi (1) i këtij neni, botuesi parashtron kërkesë në Bibliotekën Nacionale. Në shtojcë të kërkesës, botuesi e parashtron aktvendimin nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë botuese.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni botuesi-autor i veprës së vet në Bibliotekën nacionale dorëzon vetëm kërkesë.

(7) Për lëshimin e numrave standardë ndërkombëtarë paguhet kompensim. Lartësinë e kompensimit e përcakton Këshilli Drejtues i Bibliotekës Nacionale, në shumë që nuk është më e lartë se 150 euro në kundërvlerë me denarin të llogaritur për numrin e përgjithshëm të kuotave për numra standardë ndërkombëtarë të cilat Biblioteka Nacionale i lëshon për një botues gjatë një viti.

(8) Formën dhe pëmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni i përcakton ministri i Kulturës.

CIP-shkresa

Neni 9

(1) Biblioteka Nacionale lëshon CIP-shkresë nëse publikimi i përmban të dhënat nga neni 7 i këtij ligji.

(2) CIP-shkresa lëshohet për publikim të kompletuar pas këqyrjes së zbatuar në versionin final.

(3) Publikimi i cili është ndryshuar pas lëshimit të CIP- shkresës, e para fillimit të shtypjes së tij, nuk guxon të botohet me CIP- shkresë që është dhënë para ndryshimit të publikimit.

(4) Për çdo publikim të ri të lëshuar pa ndryshim, ose të ndryshuar ose të lëshuar në mënyrë plotësuese, lëshohet CIP- shkresë e re.

(5) CIP- shkresa shpallet në formë integrale ose si numër identifikimi me të cilin mbahet në bazën elektronike të të dhënave të Bibliotekës Nacionale, dhe atë grafikisht e dukshme dhe e ndarë nga të dhënat tjera të publikimit.

(6) CIP- shkresa nuk do t'i lëshohet botuesit i cili nuk ka dorëzuar ekzemplar të detyrueshëm në Bibliotekën Nacionale për publikimet e botuara paraprakisht.

(7) CIP- shkresën e lëshon Biblioteka Nacionale në afat prej shtatë ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(8) Për lëshimin e CIP- shkresës, botuesi parashtron kërkesë në Bibliotekën Nacionale. Në shtojcë të kërkesës, botuesi parashtron edhe versionin final të publikimit.

(9) Për lëshimin e CIP- shkresës paguhet kompensim. Lartësinë e kompensimit e përcakton Këshilli Drejtues i Bibliotekës Nacionale, në shumë që nuk është më e lartë se 10 euro në kundërvlerë me denarë, për botimin e një publikimi.

(10) Formën dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (8) i këtij neni i përcakton ministri i Kulturës.

Neni 10

Publikimi që nuk i përmban të dhënat nga nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji, nuk guxon të lëshohet në qarkullim dhe nuk do të pranohet në Bibliotekën Nacionale si ekzemplar i detyrueshëm.

Evidenca e të dhënave për veprimtari botuese

Neni 11

(1) Biblioteka Nacionale mban evidencë për botuesit në Republikën e Maqedonisë edhe për produksionin e tyre botues sipas bazës së tyre të të dhënave dhe raportit vjetor të botuesve nga neni 6 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi (1) i këtij neni i përcakton ministri i Kulturës.

Ekzemplari i detyrueshëm

Neni 12

(1) Për shkak të mbrojtjes, ruajtjes dhe shfrytëzimit të publikimeve, në Bibliotekën Nacionale parashtrohet ekzemplar i detyrueshëm.

(2) Ekzemplari i detyrueshëm parashtrohet në gjendje identike në të cilën është parashtruar publikimi.

(3) Ekzemplar të detyrueshëm parashtron botuesi i cili është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë për publikimet që i ka botuar si botues/bashkëbotues/producent.

(4) Botuesi parashtron pesë ekzemplarë të detyrueshëm të publikimeve nga paragrafi (3) i këtij neni, duke përfshirë edhe një kopje digjitale të publikimit sipas standardeve ndërkombëtare për qasje universale të informatave.

(5) Universitetet, përkatësisht fakultetet në Republikën e Maqedonisë parashtrojnë me nga një ekzemplar të punimeve të magjistraturës dhe doktoraturës në afat prej shtatë ditësh nga mbrojtja e tyre.

(6) Ekzemplari i detyrueshëm parashtrohet në afat prej më së shumti shtatë ditësh nga përfundimi i shtypit, përkatësisht shumëzimit të publikimit, e para lëshimit të tij në qarkullim.

(7) Në rast kur publikimi është lëshuar veç e veç në më shumë gjuhë, në alfabetë të ndryshme, në më shumë botime, me ballinë të ndryshuar, kopertina të reja, me përmbajtje të plotësuar ose të ndryshuar, ekzemplari i detyrueshëm parashtrohet për çdo gjuhë, alfabet dhe botim, për çdo botim të sërishëm, në pajtim me këtë ligj.

(8) Në rast kur publikimi shtypet, përkatësisht shumëzohet jashtë shtetit, ekzemplari i detyrueshëm parashtrohet menjëherë pas importit të publikimit (futjes në vend), e para lëshimit në qarkullim.

Neni 13

(1) Ekzemplari i detyrueshëm i publikimit elektronik parashtrohet në Bibliotekën Nacionale pa mbrojtje të qasjes, me shifër përkatëse për qasje në publikimin elektronik ose me lidhje rrjeti me emër shfrytëzimi dhe fjalëkalim për shfrytëzim të papenguar të publikimit..

(2) Biblioteka Nacionale është e obliguar të pamundësojë kopjimin dhe distribuimin e ekzemplarit të detyrueshëm të publikimeve elektronike përveç në rastet e parapara në Ligjin për të drejtën autoriale dhe të drejtat e ngjashme.

Neni 14

(1) Parashtrimi i ekzemplarit të detyrueshëm në Bibliotekën Nacionale është me kompensim, të cilin botuesi ia paguan Bibliotekës Nacionale me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni paguhet në lartësi prej ½ e çmimit të shitjes me pakicë të publikimit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, parashtrimi i ekzemplarit të detyrueshëm të publikimeve që janë të financuara me mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe të publikimeve të cilat janë të shënuara si ekzemplarë falas është pa kompensim.

Shpërndarja e ekzemplarit të detyrueshëm

Neni 15

Biblioteka nacionale e shpërndan ekzemplarin e detyrueshëm në mënyrën si vijon:

- një ekzemplar e ruan si trashëgimi kulturore (ekzemplar arkivor);
- një ekzemplar e jep për shfrytëzim në hapësirat e bibliotekës;
- një ekzemplar e shfrytëzon për përgatitjen e bibliografisë nacionale;
- një ekzemplar është për Institucionin Nacional Biblioteka Universitare "Shën Kliment Ohridski" – Manastir dhe ruhet si trashëgimi kulturore (ekzemplar arkivor);
- një ekzemplar është për Institucionin Nacional Biblioteka Universitare "Goce Dellçev" – Shtip dhe ruhet si trashëgimi kulturore (ekzemplar arkivor);

Kompetenca e Bibliotekës Nacionale në lidhje me ekzemplarin e detyrueshëm

Neni 16

Biblioteka Nacionale:

- e pranon, përpunon dhe ruan ekzemplarin e detyrueshëm;
- e jep në shfrytëzim ekzemplarin e detyrueshëm në hapësirat e bibliotekës;
- përpunon bibliografi rrjedhëse nacionale;
- kryen edhe punë tjera në lidhje me shfrytëzimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e ekzemplarit të detyrueshëm.

Mbikëqyrja

Neni 17

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji kryen Ministria e Kulturës.

Dispozita kundërvajtëse

Neni 18

(1) Gjobë në shumë prej 1 000 euro deri 1 500 euro në kundërvlerë me denarin do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- botuesi nuk cakton redaktor (neni 4 paragrafi (1)),
 - botuesi nuk parashtroi raport vjetor për produksionin botues të tij, për distribuim dhe shitje të publikimeve në Bibliotekën Nacionale (neni 6 paragrafi (3)),
 - Biblioteka Nacionale nuk lëshon numër standard ndërkombëtar në afatin e përcaktuar (neni 8 paragrafi (4)),
 - Biblioteka Nacionale nuk lëshon CIP-shkresë në afatin e përcaktuar (neni 9 paragrafi (7)) dhe
 - botuesi nuk e parashtroi publikimin elektronik në Bibliotekën Nacionale në format që është në pajtim me standardet universale ndërkombëtare për qasje të informatave (neni 13 paragrafi (1)).
- (2) Gjobë në shumë prej 500 euro deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.
- (3) Gjobë në shumë prej 500 euro deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) alinetë 1, 2 dhe 5 të këtij neni.

Neni 19

- (1) Gjobë në shumë prej 1 500 euro deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do të shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:
- para botimit të publikimit nuk lidh marrëveshje me autorin dhe me personat tjerë që marrin pjesë në përgatitjen e publikimit (neni 5 paragrafi (1)),
 - nuk e boton publikimin në tirazhin i cili është shënuar si e dhënë e detyrueshme e publikimit (neni 6 paragrafi (2)),
 - boton publikim pa i përmbajtur të dhënat e detyrueshme (neni 7),
 - në publikimi shtyp numër standard ndërkombëtar që nuk është identik me numrin që e ka lëshuar Biblioteka Nacionale (neni 8 paragrafi (3)),
 - boton publikim pa CIP-shkresë ose numër identifikimi, publikim të ndryshuar lëshon me CIP- shkresë ose numër identifikimi të dhënë para ndryshimit, ose shtyp botim të ri të publikimit me CIP- shkresë ose numër identifikimi të vjetër (neni 9 paragrafët (2), (3) dhe (4)),
 - lëshon në qarkullim publikim që nuk i përmban të dhënat nga nenet 7, 8 dhe 9 të këtij ligji (neni 10),
 - nuk dorëzon pesë ekzemplarë të detyrueshëm, përkatësisht një ekzemplar të detyrueshëm (neni 12 paragrafët (4), (5) dhe (7)) dhe
 - nuk dorëzon ekzemplar të detyrueshëm në Bibliotekën Nacionale në afatin e caktuar (neni 12 paragrafi (6)).
- (2) Gjobë në shumë prej 1 000 euro deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.
- (3) Gjobë në shumë prej 1 500 euro deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje nga paragrafi (1) alinetë 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni.

Neni 20

Për kundërvajtje nga nenet 18 dhe 19 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton gjykata kompetente.

Neni 21

Aktet nënligjore të këtij ligji do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 22

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligjit shfuqizohen dispozitat e Ligjit për ekzemplarët e detyrueshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 11/1994, 92/2008 dhe 47/11) që kanë të bëjnë me parashtrimin e publikimeve si ekzemplar të detyrueshëm në Bibliotekën Nacionale dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski" – Shkup.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë".